



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Veprimtari Kulturore „Vicianum Com“

Pronar – Qamil SAHITI

Radio VICIANUM

Rr/Faruk Beqiri, p.n.

Vushtrri

Ref:1609/986/KPM/am

## VENDIM

*për mos ripërtritje të licencës së transmetimit të Radio Vicianum, me seli në Vushtrri*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Vicianum ka qenë subjekt transmetues me mbulueshmëri lokale, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në Komunën e Vushtrris, me seli në Vushtrri, në regjionin e Mitrovicës. KPM, me datën 28 gusht 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Vicianum.
3. Me datën 28 gusht 2016, afati i licencës së Radio Vicianum ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati ka të drejtë të kërkojë ripërtëritjen e licencës nga KPM brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më datën 11 maj 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të licencuarin lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, duke e njoftuar kandidatin që të bëjë kërkesën për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen.

1/3

5. Njoftime të ngjashme me shkrim janë ridërguar tek Radio Vicianum edhe më 28 qershor 2016 dhe më 10 gusht 2016, me qëllim të nxitjes së kandidatit në fjalë për të vepruar në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së.
6. Radio Vicianum asnjëherë nuk ka parashtruar kërkesën me shkrim në KPM, për të shprehur interesimin e tij për ripërtëritje të licencës së Radio Vicianum.

### **Arsyetimi**

7. Radio Vicianum ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, duke mos parashtruar fare kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së.
8. Vendimi i KPM-së i datës 8 shtator 2016, thekson se KPM nuk do të ripërtërisë licencën asnjë kandidati i cili nuk ka parashtruar kërkesë për ripërtëritje.
9. Duke marrë parasysh se Radio Vicianum, nuk ka vepruar në pajtim me udhëzimet e KPM-së dhe në kundërshtim me nenin 25 dhe nenin 26 të Ligjit për KPM-në, KPM konstaton se ka bazë të mjaftueshme për mos ripërtitjen e licencës së transmetimit për Radio Vicianum.

### **VENDIM**

10. Komisioni merr vendim për mos ripërtitjen e licencës së Radio Vicianum.
11. Radio Vicianum, udhëzohet që të ndërpresë menjëherë veprimtarinë për ofrimin e shërbimeve audio (radio) dhe se frekuenca 105.7 MHz konsiderohet e lirë dhe kalon nën menaxhimin e KPM-së.
12. Dështimi për të zbatuar këtë vendim, që nga hyrja e tij në fuqi, do të rezultojë me masat ligjore të cilat mund të qonjë deri në konfiskimin e pajisjeve.

### **E drejta për Ankesë**


13. Në bazë të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji nr. 04/L-44), Radio Vicianum si palë në këtë rastë i njihet e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj këtij vendimi.
14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.



15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

### Lëshimi i Vendimit

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI

KRYETAR

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



19.09.2016

datë